



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.934/22

**GJYKATA KOMERCIALE** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit DPT E... nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.750/18, të datës 04.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.11.2022, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit DPT E... nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.750/18, të datës 04.11.2020, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.750/18, të datës 04.11.2020, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit DPT E... nga Prishtina. Ndërsa nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, mbetet në fuqi vendimi nr.140/2017 datës 09.06.2017 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë pala paditëse, N DPT E... nga Prishtina, për shkak të: shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet, çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

**Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala e paditur e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll i ka vërtetuar si të bazuara.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Administratës Tatimore të Kosovës – Departamenti i Ankesave, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 12.04.2018, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.140/2017 datës 09.06.2017, të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj, thëniet e padisë gjykata nuk i aprovoj, sepse i vlerësoj si të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë është aplikuar ligji material, pra e paditura ka autorizime ligjore nga dispozitat e nenit 19 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, dhe nenit 29, 30 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222, të bëj vlerësim në bazë të informatave dhe provave që siguron edhe nga palët e treta. E paditura trajtimin e deponimeve si qarkullim shtesë për paditësin e ka bërë bazuar në llogaritë bankare të paditësit dhe atë pas krahasimit të këtyre deponimeve, tërheqjeve bankare nëpër vite. Gjykata nw shkallw tw parw ka gjetur se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura por as para gjykatës, nuk ka arritur që të paraqes dëshmi konkrete dhe prova të besueshme se deponimet bankare të trajtuara me kontroll si të hyra për biznesin nuk e kanë burimin nga të ardhurat e tatueshme. Në këtë drejtim, gjykata në shkallë të parë ka vlerësuar se konstatimi i ATK-së është bazuar në provat në dispozicion dhe dispozitat ligjore të aplikueshme përkatësisht neni 19.2 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i'u ka referuar dispozitës ligjore nga neni 43 par.1 të LKA-së, me të cilën përcaktohet se *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, pasi që me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar në tërësi i'a ka falur besimin provave të ofruara nga pala e paditur, duke i trajtuar të njëjtat në detaje, por nuk i morri parasysh në asnjë rast pretendimet, kërkesat dhe propozimet palës paditëse, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova

të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa ai përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike lidhur me faktin se gjykata në shkallë të parë fare nuk i ka marrë për bazë provat e ofruara nga ana e palës paditëse sic janë kontratat e shitblerjes së paluajtshmërive të viteve 2005, 2007, 2010 dhe 2013, gjykata vlerëson se e paditura me të drejtë i ka trajtuar deponimet bankare të pa argumentuara si qarkullim shtesë, në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 19.2 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sepse deponimet bankare i takojnë vitit 2011 deri 2015, ndërsa transaksionet e paluajtshmërive vitit 2005, dhe si të tilla pas rregullimeve me kontroll, gjegjësisht verifikimit të llogarive bankare, këto deponime me të drejtë janë cilësuar si të hyra të tatueshme, e për të cilat mjete paditësi është ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë, sipas Raportit të kontrollit e për më tepër paditësi nuk ka paraqitur llogaritë bankare me të cilat do të vërtetonte se deponimet janë me përshkrim deponime nga shitblerjet e paluajtshmërive të datës 13.01.2005, 23.11.2005, 02.08.2007, sikurse pretendon, nga kjo gjykata konstaton se paditësi me asnjë dëshmi tjetër përcjellëse nuk e ka provuar pretendimin se mjetet financiare në shumën e përmendur dhe të trajtuar me kontroll si qarkullim shtesë, kanë qenë nga burimet tjera.

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË**  
**K.DH.SH.II.nr.934/22, me datë 17.11.2022**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Saranda Bogaj Sheremeti**

